



Pranuar / Doretuar Prinjenol/Prodato Received/Delivery	25.10	2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Printig Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRVISHUK	66.95/2023		116	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1116/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1116/2023 të datës 25.08.2023 të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike "Masë Disiplinore-vërejtje", kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 23.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1116/2023 e datës 25.08.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vërejtja me numër protokolli XIII-214 e datës 27.07.2023 e shqiptuar ndaj ankuses, nga Udhëheqësja e Prokurimit, në cilësinë e Udhëheqëses së drejtpërdrejtë.

A r s y e t i m

Ankuesja është e punësuar në Komunën e Obiliqit sipas Akt Emërimit të datës 01.06.2015 në pozitën e punës "Zyrtar i Lart i Prokurimit" në Drejtorinë Administratë e Përgjithshme. Me datën 27.07.2023 me numër protokolli XIII/214 Udhëheqësja e Prokurimit në Komunën e Obiliqit, në cilësinë e Udhëheqëses së drejtpërdrejtë i ka shqiptuar vërejtjen ankuses me arsyetimin se: Lidhur me procedurën e prokurimit për Projektin Ndërtimi i Parkingut në Obiliq në Objektet e Banesave Sociale/Banesa Hade me Nr.Prokurimi OB614-23-5484-5-2-1, kërkesa për fillimin e procedurës nga njësia e kërkesës ka ardhur me datë 12.05.2023, me datën 22.05.2023 e kemi dërguar njoftimin për fillimin e procedurës në AQP sipas Ligjit të LPP-së nenit 9 pika 6 e LPP-së. Me datën 26.05.2023 emailin e kam përcjellur te zyrtarja për të vazhduar procedurën pasi të përfundon

afati për fillimin e inicimit pas njoftimit sipas Ligjit në AQP. Me datën 30.05.2023. 'a filluar me inicimin e procedurës në Sistem për Publikim, ku dhe gjatë publikimit e ka ngritur paramasën në sistem me çmim të pozicioneve që e cila është e ndaluar. Data e hapjes së ofertave ka qenë me datën 19.06.2023 pra data është dashur të shtyhet për datën 26.06.2023 për këtë arsye sepse është shkruar me Formularin standard të korrigjimit. Me datën 26.06.2023 është bërë hapja e ofertave në sistem, kurse vlerësimi ka filluar me datë 30.06.2023 Komisioni i vlerësimit është H.D., V.B. dhe Z.S. Me dt. 03.07.2023 zyrtarja ka shkuar në pushim vjetor ku edhe lëndët e saj i kam marrë unë si Menaxhere ti vazhdoj me procedurat e mbetura. Me datën 06.07.2023 kam vazhduar vlerësimin e ofertave së bashku me komisionin, ku dhe gjatë kontrollit të paramasave kam hasur se ka pasur gabime aritmetikore duke filluar nga njësia e kërkesës dhe ashtu është proceduar me gabime nga zyrtarja duke e proceduar pa e kontrolluar. Konsideroj se zyrtarja bënë gabime të njëpasnjëshme që i shkaktojnë dëmë institucionit dhe gabimet e cekura më lartë konsiderohen shkelje disiplinore. Lidhur me lëndën furnizim me material Didaktik dhe Rekuizita në I.P Rrita jonë Obiliq gjithashtu ka ndodhur e njëjta procedurë ku paramasa dhe paralogarit është me çmime. Gjithashtu në shumicën prej lëndëve Deklarata e Nevojave ngritet pa data në sistem gjatë inicimit gjithashtu dhe pas njoftimit të AK-së. (gjeni të bashkangjitur disa shembuj) ku janë përsëritur thujse në të gjitha lëndët (Neni 8 përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve të Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik dhe neni 9 paragrafi 5 i LPP-së). Këto gabime janë shkelje të cilat kanë përgjegjësi dhe shkelje ligjore në fushën e prokurimit, ku dhe procedura është anuluar bazuar në lëshimin e gabimeve ku dhe lënda ka qenë Donacion nga Grandi i Performancës ku dihet që kjo lënda nëse nuk përmbillet me sukses humbë si projekt dhe ne nuk e përmbushim kriterin e performancës, gjithashtu shkeljet ligjore që nuk i përmbush sipas Ligjit dhe rregullore në fuqi.

Ankuesja e pakënaqur me vërejtjen me numër protokoli XIII-214 të datës 27.07.2023, të shqiptuar nga ana e Udhëheqëses së drejtpërdrejtë të saj, me datën 25.08.2023, ka parashtruar ankesë me datë 25.08.2023 me numër protokoli 5814/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se baza ligjore e shënuar në vërejtje sipas nenit 46 paragrafi 4 i Ligjit për Zyrtarët Publik është keq cituar sepse në të dy rastet nuk kemi cenim të nëpunësit civil, institucionit apo Shërbimin Civil në tërësi dhe as dëmë financiare apo ndonjë dëm tjetër që i është shkaktuar institucionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.09.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa Këshilli më datë 05.09.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Obiliqit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër VK/2023 me datë 06.10.2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me nr.protokoli 5814/2023 të datës 25.08.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim vërejtja me shkrim me numër protokoli XIII-214 e datës 27.07.2023; Njoftim për kontratë nr. i prokurimit OB614-23-5484-5-2-1 i datës 30.05.2023; Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues Komuna e Obiliqit i datës 11.07.2023; Njoftim për informata shtesë ose përmirësim i gabimit nr. i prokurimit OB614-23-5484-5-2-1 i

datës 30.05.2023; Njoftim për kontratë nr. i prokurimit OB614-23-4968-1-3-6 i datës 18.05.2023; Procesverbal i hapjes së tenderit nr. i prokurimit OB614-23-4968-1-3-6 i datës 30.05.2023; Njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. i prokurimit OB614-23-4968-1-3-6 i datës 08.06.2023; Njoftim për kontratë nr. i prokurimit OB614-23-7791-1-2-1 i datës 25.07.2023; Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve i datës 30.05.2023; Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve i datës 28.02.2023; Vendim i KPMSHCK me numër protokollit 4645/2023 i datës 09.06.2023; Vendim i KPMSHCK me numër protokollit 5180/2023 i datës 13.07.2023; Vendim i KPMSHCK me numër protokollit 3245/2023 i datës 31.03.2023; Vendim i KPMSHCK me numër protokollit 5620/2023 i datës 22.09.2022; E-mail nga A.A. për [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) i datës 25.08.2023; E-mail nga A.A. për [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) i datës 31.08.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë 06.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 05.09.2023; E-mail nga A.M. për R.K. i datës 04.09.2023; E-mail nga L.E. për A.M. i datës 01.09.2023; E-mail nga A.M. për L.E. i datës 29.08.2023; E-mail nga A.A. për A.M. i datës 28.08.2023; E-mail nga Xh.G. për A.M. i datës 28.08.2023; Përgjigje në ankesë e datës 04.09.2023; Vendim i KPMSHCK me numër VK/2023 i datës 06.10.2023; Akt Emërim i A.A. i datës 01.06.2015; Kërkesa për pushim e A.A. i datës 03.07.2023; Kërkesë me numër protokollit XIII i datës 29.08.2023; E-mail i datës 28.08.2023; Dëshmi në PDF; E-mail i datës 15.05.2023; E-mail i datës 23.05.2023; E-mail nga L.E. për A.A. i datës 26.05.2023; E-mail nga L.E. për A.A. i datës 26.05.2023; E-mail nga S.P. për L.E. i datës 16.05.2023; E-mail nga L.H. për C.Z. i datës 20.10.2023; Akt Emërim i L.E. me numër protokollit II-937 i datës 07.07.2023; Vendim me numër protokollit II-223 i datës 14.03.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 01.06.2015;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pabazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht Akt Emërimin e datës 01.06.2015, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtar i Lart i Prokurimit" në Drejtorinë Administratë e Përgjithshme në Komunën e Obiliqit. Ndaj ankueses Udhëheqësja e Prokurimit në Komunën e Obiliqit, në cilësinë e Udhëheqëses së drejtpërdrejtë i ka shqiptuar vërejtjen me numër protokollit XIII-214 me datë 27.07.2023.

Ankuesja e pakënaqur me vërejtjen me numër protokollit XIII-214 me datë 27.07.2023, të shqiptuar nga ana e Udhëheqëses së drejtpërdrejtë të saj, me datë 25.08.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se baza ligjore e shënuar në vërejtje sipas nenit 46 paragrafi 4 i Ligjit për Zyrtarët Publik është keq cituar sepse në të dy rastet nuk kemi cenim të nëpunësit civil, institucionit apo Shërbimin Civil në tërësi dhe as dëme financiare apo ndonjë dëm tjetër që i është shkaktuar institucionit e njëjta kërkon që ti aprovohet ankesa dhe të hiqet vërejtja me shkrim nga dosja e saj.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit i'u referua fillimisht dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 45 me të cilin është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit;

1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”.

Nenit 46 me të cilin është përcaktuar se: “... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i delhur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.

Nenit 47 paragrafit 1 me të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: “Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”.

Nenit 48 me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore “1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil.

Nenit 50 paragrafi 1, i cili ka përcaktuar se: “1.Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ndaj ankuseses sipas të gjeturave në provat e lëndës të dërguara nga organi i punësimit Komuna e Obiliqit evidentohen gabimet e bëra nga ana saj: Lidhur me procedurën e prokurimit për Projektin Ndërtimi i Parkingut në Obiliq në Objektet e Banesave Sociale/Banesa Hade me Nr.Prokurimi OB614-23-5484-5-2-1, kërkesa për fillimin e procedurës nga njësia e kërkesës ka ardhur me datë 12.05.2023, me datën 22.05.2023 e kemi dërguar njoftimin për fillimin e procedurës në AQP sipas Ligjit të LPP-së nenit 9 pika 6 e LPP-së. Me datën 26.05.2023 emailin e kam përcjellur te zyrtarja për të vazhduar procedurën pasi të përfundon afati për fillimin e inicimit pas njoftimit sipas Ligjit në AQP. Me datë 30.05.2023 ka filluar inicimin e procedurës në sistem për publikim, ku gjatë publikimit e ka ngritur parmasën në sistem me çmim të pozicioneve që e cila është e ndaluar, ku data e hapjes së ofertave ka qenë 19.06.2023 dhe e njëjta është dashur të shtyhet për datën

26.06.2023 për këtë arsye sepse është shkuar me Formularin standard të korrigjimit. Ndërsa me datë 03.07.2023 ankuesja ka shkuar në pushim vjetor, ku lëndët e saj i ka marrë Menaxherja që të vazhdoj me procedurat e mbetura. E njëjta me datë 06.07.2023 ka vazhduar vlerësimin e ofertave së bashku me komisionin, ku dhe gjatë kontrollit të paramasave kam hasur se ka pasur gabime aritmetikore duke filluar nga njësia e kërkesës dhe ashtu është proceduar me gabime nga zyrtarja . duke e proceduar pa e kontrolluar. Konsideroj se zyrtarja 'ënë gabime të njëpasnjëshme që i shkaktojnë dëmë institucionit dhe gabimet e cekura më lartë konsiderohen shkelje disiplinore. Lidhur me lëndën furnizim me material Didaktik dhe Rekuizita në I.P Rrita jonë Obiliq gjithashtu ka ndodhur e njëjta procedurë ku paramasa dhe paralogari është me çmime. Gjithashtu në shumicën prej lëndëve Deklarata e Nevojave ngritët pa data në sistem gjatë inicimit gjithashtu dhe pas njoftimit të AK-së. (gjeni të bashkangjitur disa shembuj) ku janë përsëritur thuajse në të gjitha lëndët (Neni 8 përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve të Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik dhe neni 9 paragrafi 5 i LPP-së). Këto gabime janë shkelje të cilat kanë përgjegjësi dhe shkelje ligjore në fushën e prokurimit, ku dhe procedura është anuluar bazuar në lëshimin e gabimeve ku dhe lënda ka qenë Donacion nga Grandi i Performancës ku dihet që kjo lënda nëse nuk përmbillet me sukses humbë si projekt dhe ne nuk e përmbushim kriterin e performancës, gjithashtu shkeljet ligjore që nuk i përmbush sipas Ligjit dhe rregullore në fuqi. Kolegji i Këshillit po ashtu ka pranuar nga organi i punësimit Komuna e Obiliqit dokumentet dhe videon dvd të gabimeve të përsëritura nga ana ankueses me të cilën argumentohen gabimet e bëra nga ana e saj.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesja me veprimet e saj kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar ka vepruar në kundërshtim me nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4. rrjedhimisht pretendimet ankimore të saj janë të pabazuara.

Kolegji i Këshillit po ashtu i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Neni 25 paragrafi 1, 2 dhe 3, i cili ka përcaktuar se: 1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përfundimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike.

Kolegji i Këshillit, ka vlerësuar se Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses për rastin konkret me rastin e ndërmarrjes së veprimeve ligjore lidhur me shqiptimin masës disiplinore "Vërejtjes" ndaj ankueses, ka vepruar në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në të cilin përcaktohet se: "2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil", e po ashtu edhe në pajtim me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në të cilën përcaktohet se: "2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafin 4, nën paragrafin 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit..... 4.4. si dhe neni 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, paragrafi 2 dhe 4 ku përcaktohet se: 1. Kompetent për shqiptimin e masave disiplinore sipas kësaj Rregullore janë: 1.1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt shqipton masën disiplinore të përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për shkeljet e përcaktuara me

nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit. 4. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 4.1. Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 4.2. Shkallën e fajësisë; 4.3. Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; 4.4. Përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit dhe rrjedhimisht edhe pretendimet ankimore të saj në këtë kontekst janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me objektin e ankesës së ankueses, ka konstatuar se Udhëheqësja e saj e drejtpërdrejtë në rastin konkret Udhëheqësja e Prokurimit në Komunën e Obiliqit, në cilësinë e Udhëheqëses së drejtpërdrejtë, ka arritur të konstatoj saktë gjendjen faktike dhe juridike në lidhje me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" dhe ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili thekson se: "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, sepse bazuar në konstatimet e mësipërme janë vërtetuar saktë veprimet e paligjshme të ankueses lidhur me çështjen në fjalë sipas elaborimit më lartë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1116/2023

Çlirim Zeka



Procesmbajtës

Eshref Shabani



Kryetar i Kolegjit

### Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.